



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosovo-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamusa-Municipality of Mamusa	
Çikis - Dalëse - Izlazna - Outgoing	No.Nr. 03-20
Tarih/Date	28.02.2020

01-Nr-03-20

Më date: 28.02.2020

Ne baze te neneve 12, 17 lidhur me nenin 28 dhe 29, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 6, pika 2.1 lidhur me pikën 6, të Ligjit Nr-04/L-010 për bashkëpunim ndër-komunal, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-7/2011” dhe konform nenit 5, paragrafi 1, pika 1.1 lidhur me nenin 6, të Rregullores Nr. 09/2013 për nxitjen e bashkëpunimit ndër-komunal dhe neneve 17, 18, 44, pika 1 të Statutit të Komunës së Mamushës, në mbledhjen e mbajtur me datën, 28.02.2020, miratoh këtë:

V E N D I M

Neni 1

- 1.1 Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Mamushës për të hyrë në bashkëpunim ndër-komunal me Komunat tjera të Republikës së Kosovës.
- 1.2 Bashkëpunimi ndër-komunal do të zhvillohet në mesë të Komunave tjera të Republikës së Kosovës si në vijim:
 - 1.2.1 Komunës së Suharekës të Republikës së Kosovës
 - 1.2.2 Komunës së Prizrenit të Republikës së Kosovës
 - 1.2.3 Komunës së Dragashit të Republikës së Kosovës dhe
 - 1.2.4 Komunës së Mamushes të Republikës së Kosovës

Neni 2

AUTORIZOHET, Kryetari i Komunës që të fillon konsultimet dhe bisedimet për hartimin e marrëveshjes për bashkëpunim ndër-komunal në mesë të Komunës së Suharekës të Republikës së Kosovës, Komunës së Prizrenit të Republikës së Kosovës, Komunës së Dragashit të Republikës së Kosovës dhe Komunës së Mamushesë të Republikës së Kosovës dhe palët tjera të interesuare për bashkëpunim.

Neni 3

OBLIGOHET- Kryetari i Komunës që pas përfundimit të konsultimeve dhe në bazë të konsultimeve paraprake të përgatisin draft-marrëveshjen për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal në mesë 4, (katër) Komunave dhe atë në kuadër të kompetencave të tyre vetanake, financimin e “Qendrës për strehimin e grave dhe fëmijëve” dhe nënshkruhet nga Kryetaret e Komunave dhe miratohet nga Kuvendet Komunale të Komunave që janë pjesëmarrse në bashkëpunimin ndër-komunal.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Mamushës, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008”), nenit 8, të Rregullores, Nr-01/2016, për shqyrtimin administrative të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË MAMUSHË

